

BORDI I MBIKQYRJES PUBLIKE

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E KONTROLLIT TË CILËSISË SË SHOQËRIVE ME INTERES PUBLIK

Mbështetur në nenin 3, pika 1, 2 dhe në nenin 5, pika 1/d të Ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të rregjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, Bordi i Mbiqyrjes Publike miraton këtë rregullore, për organizimin e kontrollit të cilësisë së shoqërive me interes publik me Vendimin e tij nr.17 datë 30.05.2011 si dhe me ndryshimet e bëra me Vendimin nr. 36 datë 30.07.2012.

- 1- Bordi me vendim të vecantë përcakton kriteret për përzgjedhjen e 6 inspektorëve të kontrollit të cilësisë (1 prej tyre krye/inspektor) nga grupi i kontrollorëve të IEKA-s dhe cakton honoraret përkatëse për cdo dosje që do të kontrollohet. Honorari për vitin 2012 është për cdo dosje 30.000 lekë për kontrollorin dhe 15.000 lekë për rishikuesin. Ky honorar do të rishikohet cdo vit përpara fillimit të procesit të kontrollit.
- 2- Bordi identifikon profesionistët, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në shtojcën 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje, në radhë të parë në grupin e kontrollorëve të IEKA-s dhe mund të shtrijë përzgjedhjen edhe jashtë këtij grupi në ushtrues apo jo të profesionit, apo të punësuar, dhe i fton ata (short-list) të marrin pjesë në kandidimin si inspektor të kontrollit të cilësisë së auditimit të shoqërive me interes publik. Pas shqyrtimit të kandidaturave, bordi përzgjedh inspektorët dhe komunikon përzgjedhjen e tij IEKA-s për përfshirjen e tyre në grupin e kontrollorëve nëse ata nuk janë.
- 3- Në fillim të cdo viti ushtrimor, Bordi merr një listë të azhornuar nga IEKA të shoqërive me interes publik dhe kabinetin apo EKR përkatës.
- 4- Mbi bazën e kësaj liste bordi me një vendim të vecantë pasi përcakton numrin e dosjeve që do të kontrollohen, i paraqet organizatës (IEKA) kërkesën për sigurimin e fondit të nevojshëm për pagesën e inspektorëve dhe rishikuesve.
- 5- Bordi zgjedh me short nga totali i dosjeve të auditimit ligjor të shoqërive me interes publik duke siguruar që të ketë te paktën 1 dosje për cdo Kabinet që ka kryer auditim të shoqërive me interes publik dhe nga cdo sektor i ekonomisë (psh. institucione financiare, telekomunikimi, shërbime publike, etj).
- 6- Për cdo dosje do të caktohet një **Grup Kontrolli** që përbëhet minimalisht nga **1 Inspektor** dhe **1 Rishikues**. Zgjedhja e Grupit të Kontrollit do të bëhet me short për cdo dosje duke siguruar një ngarkesë të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces. Anëtarët e grupit

të Kontrollit përpara caktimit të misionit, bëjnë një deklaratë të pavarësisë nga subjekti që do kontrollohet.

- 7- Monitoruesi është anëtar i Bordit. Monitoruesi do të mbikqyrë gjithë procesin e kontrollit duke qënë ose jo i pranishëm gjatë kontrollit të kabinetit të auditimit dhe dosjes së auditimit. Misioni i monitoruesit është mbikqyrja e procedurave të ndjekura nga grupi i kontrollit dhe zbatimi i manualit të kontrollit. Monitoruesi nuk ka të drejtë të japë vlerësimet e tij apo të ndërhyjë në raportin e kontrollit të përgatitur nga grupi i kontrollit.
- 8- Rishikuesi është pjesë e grupit të kontrollit. Misioni i tij është këshillimi i kontrolluesit gjatë planifikimit dhe kryerjes së kontrollit si edhe rishikimi i gjithë procedurave të kontrollit dhe konkluzioneve të kontrollit. Rishikuesi mund të marrë përsipër kontrollin e asaj pjese të dosjes së auditimit që ka lidhje me çështje të komplikuar dhe me rrezik të lartë auditimi.
- 9- Kontrolli i cilësisë së shoqërive me interes publik kryhet duke zbatuar procedurat e percaktuara në këtë rregullore si edhe manualin (apo pyetsorin) e kontrollit të cilësisë së shoqërive me interes publik në shtojcën 2 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
- 10- Vendimi për kontrollin e cdo dosje, duke përfshirë përcaktimet e pikës 11-14 më poshtë, i dërgohet IEKA-s e cila njofton subjektin që do kontrollohet që të marrë masa që kontrolli të kryhet në mënyrë eficiente. Kontrolli i dosjes kryhet në ambjentet e kabinetit të auditimit, dhe nëse subjekti nuk ka të tilla, atëherë dosja dërgohet në ambjentet e IEKA-s me apo pa praninë e përfaqësuesve të kabinetit të auditimit.
- 11- Bordi harton një deklaratë konfidencialiteti duke respektuar kërkesat e kodit të etikës e cila i jepet subjektit që kontrollohet e firmosur nga grupi i kontrollit.
- 12- Kontrolli duhet të kryhet nga 5 deri në 10 ditë pas marrjes së vendimit për kontrollin e saj. Grupi i Kontrollit planifikon ditën saktë që do të fillojë kontrollin dhe ia komunikon subjektit që do kontrollohet. Emri i dosjes së auditimit është sekret dhe i komunikohet kabinetit në ditën që fillon kontrolli.
- 13- Pas përfundimit të kontrollit të dosjes, rishikimi i kontrollit kryhet në ditën në vazhdim. Kontrollori së bashku me rishikuesin pas përfundimit të kontrollit, një ditë më pas, përfundon Raportin me konkluzionet të cilat, këto të fundit, pasi i firmosin ia dërgojnë subjektit të kontrolluar, i cili paraqet komentet e tija të firmosura. Subjekti ka një afat 5 ditë pune, pas dërgimit të konkluzioneve nga inspektori, që të dërgojë komentet në lidhje me konkluzionet e kontrollit;
- 14- Pas marrjes së komenteve nga subjekti, kontrollori bën vlerësimin sipas këtyre kategorive:

a. Shumë Mirë,

- b. Mirë,**
- c. Mjaftueshëm,**
- d. Pamjaftueshëm**

Pyetsori së bashku me vlerësimin dhe komentet rishikohet nga Rishikuesi dhe opinioni i tij së bashku me dokumentet më sipër i përcillen bordit për shqyrtim dhe vendim.

15- Cdo anëtar i Bordit mund të investigojë më tej, kur e gjykon të nevojshme në lidhje me relacionin dhe rezultatet e kontrollit dhe mund të propozojë një vlerësim të ndryshem nga ai i Grupit të Kontrollit. Bordi merr vendim për vlerësimin përfundimtar të cdo dosje.

16- Për dosjet që do vlerësohet Pamjaftueshëm apo Mjaftueshëm, Bordi përcakton edhe masën disiplinore sipas ligjit 10091 datë 05/03/2009 dhe ja përcjell vendimin për ekzekutim Autoritetit të Rregjistrimit. Ky vendim është i padiskutueshëm dhe përfundimtar.

17- Të gjitha vendimet e bordit të pikës 16 më sipër bëhen publike në faqen e internetit në mënyrë të përmbledhur.

18- Dosja e kontrollit së bashku me të gjitha materialet përfundimtare, arshivohet një kopje pranë sekretarisë së BMP-s dhe një tjetër pranë IEKA-s.